



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:277362

Datë: 22.08.2024

Numri i dokumentit: 06077939

C.nr.488/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË / Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Hatixhe Begaj, në çështjen juridike të paditësit M.Z., nga fshati B., Komuna e Malishevës, të cilin e përfaqëson avokat Asman Hoxha nga Prizreni Rr. “William Woker” Blloku A/1 kati I nr.5, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë - shujtave ditore, vlera e kontestit 362.00 €, jashtë shqyrtimit me datë 22.08.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit M.Z., nga fshati B., Komuna e Malishevës, i punësuar pranë shkollës SHFMU “Ismail Qemali” në B. Komuna e Malishevës, ashtu që **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës - shujtave ditore, t’ia paguajë paditësit M.Z. **shumën në lartësi të përgjithshme prej 362,00 euro, për gjithsej 181 ditë pune**, nga 2 (dy) euro për secilën ditë të prezencës në punë, për vitin 2021 (01.01.2021-31.12.2021).

Shumën e lartcekur, detyrohet e paditura që paditësit të ia paguajë me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet që nga dita e paraqitjes së padisë dt.06.11.2023, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësi M.Z., i punësuar pranë shkollës SHFMU “Ismail Qemali” në B. Komuna e Malishevës, të cilin e përfaqëson të cilin e përfaqëson avokat Asman Hoxha nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike kompensim për shujtat ditore të paraparë me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë nenin 35 pika 7, sipas të cilës kërkon të paguhet në emër të shujtave ditore, për vitin 2021 për 207 ditë pune, në shumën prej 362 euro, sipas vërtetimit të lëshuara nga shkolla SHFMU “Ismail Qemali” në B. Komuna e Malishevës, të gjitha këto me kamatë prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

E paditura përmes përgjigjes së saj në padi të dt.21.05.2024 ku ndër të tjera ka theksuar se këtë kërkesë e konsiderojmë si plotësisht të pa bazuar sepse kërkesa e palës nuk është e mbështetur në kontratën kolektive të vitit 2021, pasi që e njëjta është shkëputur nga MASHT me 22.11.2022 dhe tani nuk është në fuqi dhe padia është parashtruar jashtë afatit ligjor sa ka qenë në fuqi kjo kontratë me dt.06.11.2023 dhe konsiderojmë se është e pasafatshme, dhe ky borxh është parashtruar pasi kontrata nuk ka bazë ligjore dhe është e skaduar duke propozuar që padinë ta hedh poshtë si të pabazuar në kontratën kolektive të vitit 2021.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Themelësia e kërkesëpadisë del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konkretisht nga kontrata e punës me nr.protokolli 11/521 e dt.09.10.2015, vërtetimi i datës 16.02.2022, i lëshuar nga shkolla SHFMU "Ismail Qemali" në B. Komuna e Malishevës, nga të cilat vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune të e paditura në këtë shkollë, si dhe nga i njëjtit vërtetohet vijueshmëria në punë e paditësit për vitin 2021, periudhë kjo për të cilën paditësi kërkon kompensimin e shujtave të ushqimit për 181 ditë pune, se paditësi ka këto ditë pune u vërtetua përmes vërtetimit të lartëcekur, e të cilave prova gjykata ia fali besimin e plotë duke u bazuar edhe në nenin 329.1, të LPK-së, në të cilin përcaktohet që "*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*", pasi janë lëshuar nga institucionet arsimore të së paditurës.

Në bazë të provave të sipërpërmendura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në punë pranë SHFMU "Ismail Qemali" në B. Komuna e Malishevës, ndërsa kontestues mes palëve ndërgjyqëse rezulton të jetë e drejta në emër të kompensimit të shujtave ditore.

Sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021, është paraparë se: 35.7 "*Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim*". Sipas dispozitës në fjalë paditësit i takojnë shpenzimet e ushqimit.

Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës Nr.03/L-212, neni 90 par. 5 e që përcakton se "*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive*", e që nënkupton detyrimin e punëdhënësit përkatësisht të paditurës për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, e njëjta e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që prodhon efekt juridik për punëdhënësit që kanë të punësuar, sepse të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë dhe e paditura është punëdhënësi i paditësve prandaj detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë.

Njëkohësisht, meqenëse u konstatua se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër faktit se e paditura e ka kontestuar vlerën e borxhit sa i përket kompensimit të mjeteve në emër të shujtave ditore, megjithatë për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme, dhe si të

tilla janë të besueshme dhe mbi bazën e provave të administruara, konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa shqyrtim të çështjes, sipas dispozitës së nenit 152 të LPK-së në të cilën është përcaktuar se *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, e që në këtë rast e paditura përmes përgjegjës në padi nuk i ka kontestuar fare faktet vendimtare përveç që është e kontestuar e drejta e kompensimit të shujtave ditore si e pa bazuar në kontratën kolektive, andaj gjykata duke interpretuar të njëjtën me dispozitat e nenit 396 par.2 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se *“Po që se i padituri e konteston kërkesëpadinë, përgjigja në padi duhet t'i përmbajë edhe faktet mbi të cilat i padituri i mbështetet thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e tilla”*, në çështjen konkrete juridike vlerëson se paditura nuk i ka bashkangjitur asnjë provë konkrete parashtresës së përgjigjes në padi, me të cilat do ti vërtetonte pretendimet e saj.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës sa i përket asaj se kjo padi nuk ka bazë ligjore, mirëpo gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkëputjen e kontratës kolektive dhe se kjo kontratë nuk është në fuqi, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësi sipas padisë kërkon realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive.

Si pretendim tjetër të dhënë në përgjigje në padi, se në rastin në fjalë kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit, gjykata një pretendim të tillë e refuzon si të pabazuar, për arsye se konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret paditësi ka kërkuar që t'i kompensohen shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore të specifikuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa padinë e ka paraqitur me 06.11.2023, pra brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se për vitin 2021 paditësi ka gjithsejtë 181 ditë pune, andaj $(181 \times 2=362)$ të njëjtit i takojnë 362 euro në emër të shujtave ditore. Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e ushqimit (shujtave) në punë.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ka marr datën e ushtrimit të padisë (data 06.11.2023), e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet shumës prej 104 euro për përpilim padie dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 20 euro, duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve numri tarifor 6.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 152 të LPK-së, e në lidhje me dispozitat e nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 par.1 dhe 2 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORË NË GJAKOVË- DEGA NË MALISHEVË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.488/23 dt.22.08.2024.

Gjyqtarja
Hatixhe Begaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.